



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 187/4 Prot

Tiranë, më 13.05.2022

V E N D I M

Nr.66, datë 13.05.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, për vlerësimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, për plotësimin e pozicionit “Drejtor i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të pikës 2, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, mbi trajtimin e informacionit, për vlerësim të padrejtë në dy procedura konkurimi,

VËREJ SE:

Në informacionin e regjistruar me nr. 787, datë 08.09.2021, pretendohet për parregullsi të lejuara në zhvillimin e procedurës së konkurrimit të shpallur me kod #3499, pozicioni i punës “Drejtor i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”, lloji i diplomës “Master Shkencor” me 120 kredite dhe diploma “Bachelor” në të njëjtën fushë.

Pasi filloi procesi i verifikimit paraprak të këtij informacioni, Departamenti i Administratës njoftoi Komisionerin se, kishte vendosur nisjen e një hetimi administrativ, kryesisht, lidhur me parregullsi të lejuara në procesin e konkurrimit dhe emërimit të *****, në pozicionin “Drejtor i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor” dhe se, në përfundim të këtij hetimi do të njoftonte për rezultatin dhe vendimmarrjen eventuale.

Në përgjigje të sa më sipër, me shkresën nr. 187 prot., datë 23.02.2022, Departamenti i Administratës Publike ka informuar Komisionerin se, nga hetimi administrativ i kryer, si dhe pas shqyrtimit të informacionit të përcjellë nga organet kompetente (*“Ministria e Arsimit dhe Sportit”* dhe Universiteti i Shkodrës *“Luigj Gurakuqi”*) ka rezultuar se nëpunësi ***** , në momentin e kryerjes së konkurrimit për ngritje në detyrë, në pozicionin *“Drejtor i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”* nuk plotësonte kriterin e posaçëm të pozicionit të punës, atë të diplomës së nivelit *“Master Shkencor”* apo *“Master Profesional”* të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje 2 vite akademike, në Shkenca Shoqërore.

Nga sa më sipër, me vendimin e tij nr. 07, datë 18.02.2022 *“Për anulimin e aktit nr. 2752 prot., datë 27.04.2021 të njësisë përgjegjëse për emërimin e ***** , në pozicionin Drejtor i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor – kategoria III-a”*, DAP ka vendosur:

1. Të anulohet aktin nr. 2752, datë 27.04.2021, të nxjerrë nga DAP, për emërimin e ***** në pozicionin *“Drejtor i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”*.
2. Lënien në fuqi të aktit të emërimit nr. 8091 prot., datë 13.11.2018, për emërimin e ***** në pozicionin *“Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”*.

Në vijim të procedurës hetimore, DAP i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për mundësinë e sistemimit të nëpunësit në fjalë në një nga vendet vakante të ministrisë ose institucionet e varësisë, ku ai përmbush kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të vendeve të punës, nga ku ka rezultuar se nuk ka vakanca të përherëshme ku nëpunësi ***** mund të sistemohet në mënyrë të përherëshme, me përjashtim të vakancës së përkohshme të pozicionit *“Specialist në Sektorin e Përpunimit, Menaxhimit të Arkivës dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”*, ku ai është sistemuar përkohësisht.

Për sa u përket, duke qenë se në informacionet e paraqitura pranë Komisionerit nuk u paraqitën fakte apo rrethana për hapa të tjerë, konkretë, për zbatimin e aktit të mësipërm të Departamentit të Administratës Publike, me anë të shkresës së dërguar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, protokolluar me nr. 187/1, datë 11.03.2022, është kërkuar të vijohet me veprime administrative konkrete, lidhur me zbatimin e këtij vendimi, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike.

Pavarësisht kësaj, Komisioneri vlerëson të arsyeshme që të shprehet me vendimin e tij për marrjen e masave organizative e administrative të nevojshme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në nenin 90 pika 2, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi*

i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Ministria e Drejtësisë, e cila në këtë rast paraqitet si menaxhere e burimeve njerëzore të institucionit të saj të varësisë, Drejtorisë të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, të nxjerrë aktet përkatëse për zbatimin e vendimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 07, datë 18.02.2022 “*Për anullimin e aktit nr.2752 prot., datë 27.04.2021 të njësisë përgjegjëse për emërimin e *****, në pozicionin Drejtor i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor – kategoria III-a*” dhe të urdhërojë kthimin e nëpunësit në fjalë në një pozicion të nivelit ekzekutiv, për të cilin ai kishte statusin e nëpunësit civil, para pjesëmarrjes në konkurrimin për ngritje në detyrë, të shpallur me kod # **3499** – Drejtor i Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.
2. Departamenti i Administratës Publike të ndjekë zbatimin e vendimit që ka marrë, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni e vendimit.
4. Në rast të mos respektimit të vendimit, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimin dhe në zbatim të përcaktimit të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës, për moszbatimin e masës së përcaktuar në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtoria e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha